



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**KUVENDI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, në pajtim me nenin 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr.06/L-005, nenet 14 dhe 15 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2022, miratoi këtë,

**VENDIM**  
**PËR CAKTIMIN E NORMAVE TATIMORE PËR TATIMIN NË PRONËN E**  
**PALUAJTSHME PËR VITIN 2023**

**Neni 1**

**Normat Tatimore**

1. Caktohen normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave në territorin e Komunës së Podujevës, me përjashtim të kategorisë-pronë publike dhe përshtimeve tjera sipas legjislacionit në, si vijon:

1.1. Për njësitë bujqësore të parcelave.....	0.15 %
1.2. Për njësitë bujqësore të objekteve.....	0.15 %
1.3. Për njësitë pyjore të parcelave.....	0.15 %
1.4. Për njësitë rezidenciale të parcelave.....	0.15 %
1.5. Për njësitë rezidenciale të objekteve.....	0.15 %
1.6. Për njësitë komerciale të parcelave.....	0.15 %
1.7. Për njësitë komerciale të objekteve.....	0.20 %
1.8. Për njësitë industriale të parcelave.....	0.15 %
1.9. Për njësitë industriale të objekteve.....	0.15 %

2. Normat tatimore sipas këtij neni caktohen konform Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, (neni 9 paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9).

**Neni 2**

**Zbatimi**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa - Zyra e Tatimit në Pronë.

**Neni 3**

**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëre me Rregulloren nr.06/2021, dhe i njëjti zbatohet nga data 01 janar 2023.

Nr.prot. 01-414/04-0062838/22  
Podujevë, datë; 29 korrik 2022



Kryesuesi i Kuvendit  
Hilmi Hoxha